

VENDIM
Nr. 27, datë 9.3.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE MIDIS KESH SHA/FPSH DHE OSHEE SHA/FPP**

Në mbështetje të nenit 16, 20 germa “h”, 108, 110 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” pikat 4; 14, germa “A”, pika 2 dhe pika 7, germa “F”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, kapitulli V i Rregullave të Tregut Shqiptar, miratuar me vendimit nr. 68, datë 23.6.2008 të ERE-s, i ndryshuar, dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, pasi u njoh me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., për miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike midis KESH sh.a./FPSH dhe OSHEE sh.a./FPP për periudhën 1 janar 2016 – 30 qershor 2016, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- KESH sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 6.2.2014.

- OSHEE sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014.

- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë lidhur në datën 31.12.2014, marrëveshjen për furnizimin me energji elektrike nëpërmjet FPSH/KESH sh.a. dhe FPP/OSHEE sh.a., me afat 1-vjeçar (njëvjeçar), miratuar me vendimin e ERE-s nr. 11, datë 4.2.2015.

- Palët kanë nënshkruar bashkërisht këtë marrëveshje, e cila i shtrin efektet nga data 1 janar 2016 deri në datën 30 qershor 2016.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjitik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij; po ashtu në kuptim të nenit 109, pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

- Baza ligjore e përdorur nga palët për nënshkrimin e kësaj marrëveshje është e pasaktë:

- a) Vendimi nr. 68, datë 23.6.2008, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar”, me të gjitha ndryshimet e tij është baza ligjore e saktë që duhet të përdoret. Si rrjedhojë vendimi nr. 10, datë 27.1.2016 “Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, “Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike” nuk duhet të citohet në mënyrë të veçantë.

- b) Vendimi i pasqyruar me nr. 58, datë 3.6.2008, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, duhet të jetë vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, “Për licencimin e shoqërisë operatori i shpërndarjes të energjisë elektrike sh.a. në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH/KESH sh.a. dhe FPP/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2016 deri në datën 30.6.2016, me ndryshimet përkatëse në bazën ligjore në përmbajtje të marrëveshjes si më poshtë:

- a) Vendimi nr. 10, datë 27.1.2016, “Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, “Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, duhet të zëvendësohet me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar”, i ndryshuar

b) Vendimi nr. 58, datë 3.6.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, duhet zëvendësohet me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike sh.a., në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016 – 30 qershor 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti